

**AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Mikado Buggy Service” sh.p.k.**

Sot me 26.03.2024 (dymijë e njezit e kater), une ortaku:

Z. **Dritan Shakohoxha** shtetas shqiptar, lindur ne Vlore me date 15.07.1969, banues ne Tiranë në adresën: Rr. Budi nr 11/7 , identifikuar me letërnjoftim BA1392121,

Madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, nëpërmjet këtij akti themeloj sot me vullnetin tim të lirë e të plotë një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar sipas dispozitave te mëposhtme.

***Neni I.
Krijimi dhe Emërtimi***

1.1 Personi i mësipërm krijon sot sipas legjislacionit shqiptar nje shoqëri me përgjegjësi te kufizuar, me emërtimin “Mikado Buggy Service” sh.p.k. me poshte e quajtur “Shoqëria”. Emërtimi i shkurtuar është “Mikado Buggy Service”.

***Neni II.
Selia e Shoqërisë***

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresën Green Coast Palace,Himare Shqipëri. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me Vendimin e Asamblesë së Ortakëve. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, agjencive, zyrave të përfaqësimit apo degëve të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si edhe jashtë saj.

***Neni III.
Objekti i Aktivitetit***

3.1 Ofrimin e shërbimeve :

- a- Shërbime Transport prane rezorteve turistike
- b- Rezervime shërbimesh hotelerie on-line
- c- Rezervime paketash turistike .
- d- Rezervime eventesh kulturore dhe sportive.
- e- Cdo veprimtari tjetër e lejuar nga ligji.

***Neni IV.
Kohëzgjatja***

4.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë pa afat.

4.2. Shoqëria mund të priset përpara këtij afati ose mund të ndryshojë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni V.
Kapitali Themeltar

5.1 Kapitali i nënshkruar dhe plotësisht i paguar i Shoqërisë është 1.000 (nje mijë) Lekë, i cili përbëhet nga 10 (dhjete) pjesë me vlerë nominale prej 100 (njqind) lekë secila.

5.1 Kontributet në kapitalin e Shoqërisë janë nënshkruar e derdhur tërësisht në para si më poshtë nga ortakut:

Z. **Dritan Shakohoxha** shtetas shqiptar, lindur ne Vlore me date 15.07.1969, banues ne Tiranë në adresën: Rr. Budi nr 11/7 , identifikuar me letërnjoftim BA1392121 te cilit i perkasin 10(dhjete) pjese me vlere 100 (njqind) lek secila qe i korespondojne 100(njqind)% te kapitalit te shoqerise te barazvlefshme me 1000 (nje mije) lek.

Neni VI.
Administrimi i Shoqërisë

6.1 Shoqëria administrohet nga Administratori i cili qëndron në detyrë për periudhën e parashikuar nga ligji deri në revokimin e tij sipas Statutit të Shoqërisë.

6.2 Administrator i shoqërisë Z. Dritan Shakohoxha shtetas shqiptar, lindur ne Vlore me date 15.07.1969, banues ne Tiranë në adresën: Rr. Budi nr 11/7 , identifikuar me letërnjoftim BA1392121

6.3 Përfundimisht, afati i Administratorit është deri ne 26,03,2029.

6.4 Administratori, në përputhje me Statutin e Shoqërisë, ka të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë brenda kufijve të objektit të veprimtarisë, me përjashtim të atyre që ligji ose Statuti ia rezervon Asamblesë.

6.5 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit i cili mban kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë brenda kufijve të objektit të veprimtarisë, me përjashtim të atyre që ligji ose Statuti ia rezervon Asamblesë.

6.6 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuar veprimesh.

6.7 Administratorit mund t'i jepet një shpërblim vjetor, i cili duhet të përcaktohet me vendim të Asamblesë dhe në përputhje me nenin 97 të ligjit për shoqëritë tregtare.

6.8 Me vendim të Administratorit Shoqëria mund të drejtohet ne aktivitetin tregtar nga 1 (një) Drejtor i Përgjithshëm.

6.9 Administratori i shoqërisë kryen funksionet dhe mban kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë, deri në një vendim nga Administratori për emërimin e një personi të ndryshëm nga ai në funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm.

6.10 Drejtori i Përgjithshëm drejton aktivitetet e shoqërisë dhe ekzekuton Direktivat e Asamblesë së ortakëve e të Administratorit të shoqërisë duke raportuar periodikisht përpara tyre.

6.11 Drejtor i Përgjithshëm mund të zgjidhet edhe një person që nuk është Administrator ose Ortak i shoqërisë.

Neni VII.
Dispozitat e Organizimit

7.1 Dispozitat mbi organizimin, si dhe rregullat mbi drejtimin e administrimin e aktivitetit të Shoqërisë dhe çështjeve të brendshme, janë parashikuar në Statutin e saj i cili modifikohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

ORTAKU

Z. Dritan Shakohoxha

Dritan Shakohoxha
